AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Gusht 2023

08.09.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Gusht 2023, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 3,2% vjetore dhe 1,0% mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 3,2% në muajin Gusht 2023, krahasuar me muajin Gusht 2022. Inflacioni mujor ishte 1,0% në muajin Gusht 2023.

Gusht 2023 / Gusht 2022 3,2 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 3,2% në muajin Gusht 2023 krahasuar me muajin Gusht 2022.

Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: perimet (28,0%), pemët (11,4%), mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë (7,2 %), pijet alkoolike, duhani (6,3%), pijet joalkoolike (5,7%), blerja e automjeteve (5,1%), buka dhe drithërat (4,5%), energjia elektrike, gaz dhe lendet djegëse të tjera (4,5 %), shërbimet për transport (4,4%), mishi (3.8%) dhe qumështi, djathi dhe vezët (2,4 %), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 3,4 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: vajrat dhe yndyrat (-14.5%) dhe lënde djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (-3,7%) dhe me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,2 për qind në IHÇK-it.

Gusht 2023 / Korrik 2023 1,0 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej (1,0 %) në muajin Gusht 2023 krahasuar me muajin Korrik 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOPI-it: biletat e fluturimeve (8,4 %), karburantet dhe lubrifikantet për pajisjet e transportit personal (5,3 %), perimet (4,8 %), shërbimet për transport (4,7%), mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë (1,2%), blerja e automjeteve (1,1%) dhe pijet alkoolike, duhani (0,9 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 1,0 për qind në IHÇK-it.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it, Kosovë

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2023 në ‰	VIII - 2023 2015=100	VIII - 2023 VII- 2023	VIII - 2023 VIII- 2022
00	Gjithsej IHÇK	1000	128,5	1,0	3,2
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	381,9	141,9	0,6	5,5
02	Pijet alkoolike, duhani	64,4	136,4	0,9	6,3
03	Veshje dhe këpucë	41,1	105,6	0,3	3,3
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89,4	118,8	-0,2	4,2
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	62	120,2	1,2	7,2
06	Shëndetësia	24,1	115,4	-0,1	2,4
07	Transporti	182,9	124,9	3,4	-3,8
08	Mjetet e komunikimit	21,9	114,6	-0,1	-0,4
09	Rekracioni dhe kultura	36,6	105,0	1,1	0,8
10	Arsimi	5,9	104,9	0,0	2,8
11	Restorantet dhe hotelet	32,1	129,0	0,9	4,2
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	57,8	117,6	0,2	3,5

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Gusht 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/cmimet

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS